



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 10 Datë 05. 09. 2017

“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “ ERIM ” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, miratimin paraprak Nr. 3886/6, datë 10.10.2016 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujqor të subjektit “**ERIM**” **SH.P.K.**, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujqor Drin- Bunë,

V e n d o s i :

1-Miratimin e lejes së subjektit “**ERIM**” **sh.p.k.** me administrator Z.Ismail SHYTI, për përdorim të burimit ujqor **Përroi i Hetmit dhe Përroi Sheshit të Vogël**, degë e Lumit Zalli i Bulqizës, degë e Lumit Drin i Zi , për prodhim energjie elektrike në Fshatin Fushë Bulqizë, Njësia Administrative Fushë Bulqizë , Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC SHYTAJ do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës marrjes 1 $X_1 - 44\ 40\ 153.08;$ $Y_1 - 46\ 03\ 783.5;$ $Z_1 - +1200.4m$

Koordinatat e veprës marrjes 2 $X_2 - 44\ 40\ 011.1;$ $Y_2 - 46\ 03\ 700;$ $Z_2 - +1202.6m$

Koordinatat e veprës marrjes 3 $X_3 - 44\ 39\ 787.5;$ $Y_3 - 46\ 03\ 265.8;$ $Z_3 - +1200\ m$

Koordinatat e veprës marrjes 4 $X_4 - 44\ 39\ 000;$ $Y_4 - 46\ 02\ 695.2;$ $Z_4 - +1220\ m$

Koordinatat e godinës së centralit: $X - 44\ 39\ 939.6;$ $Y - 46\ 02\ 391.6;$ $Z - +957\ m;$

Koordinatat e pikës së shkarkimit: $X - 44\ 39\ 939.6;$ $Y - 46\ 02\ 391.6;$ $Z - +957\ m;$

Prurja mesatare vjetore e burimit : $Q_{1mes}=Q_{2mes}=Q_{3mes}=0.04m^3/sek;$ $Q_{4mes}=0.06m^3/sek;$

Sasia e ujqit që kërkohet të përdoret: $Q_{1llog}= Q_{2llog}=Q_{3llog}= 0.08m^3/sek;$ $Q_{4llog}=0.12m^3/sek;$

Prurja ekologjike: $Q_{1ekol}=Q_{2ekol}=Q_{3ekol}=0.01m^3/sek;$ $Q_{4ekol}=0.025m^3/sek;$

Prurja që shkarkohet: $Q= 0.36\ m^3/sek.$

2-Leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari

Martin PLLUMBI



Kryetar

Paulin RADOVANI